




Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Përsone

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 03

Datë: 03.03. 2020.

KONTRATË PROKURIMI Nr 02

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

" ECM ENGINEERING " SH.P.K. me seli në Prishtinë me Nr biznesi 810106527
(në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

SHPURJA E PUSIT PËR SHKOLLËN FILLORE " HILMI HOTI " NË FSHATIN CARRALLUKË me numër identifikues: 62500.20.01.536

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: SHPURJA E PUSIT PËR SHKOLLËN FILLORE "HILMI HOTI " NË FSHATIN CARRALLUKË.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e shpurjes së pusit për shkollën fillore " Hilmi Hoti " në fshatin Carrallukë.

1.3 Afati kohor i përformances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë: NË FSHATIN CARRALLUKË.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 **Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 **ÇMIMI**

3.1 Çmimi total i kontratës është : **8,402.96€** (me shkronja) :

(tetëmijëekatërqindëedyeuroenëntëdhjetëegjashtëcentë)Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3 **Menaxhimi i Kontratës**

Menaxhimin e Kontratës shpurja e pusit për shkollën fillore "Hilmi Hoti" në fshatin Carrallukë do ta bëjë zyrtari i Urbanizmit z.Driton Krasniqi i caktuar nga ZKA i AK-së .

Neni 3.4. **Obligimet e OE**

OE është i obliguar që shpurjen e pusit për shkollën fillore " Hilmi Hoti " në fshatin Carrallukë ta kryej në përputhshmëri të plotë me specifikacionin e ofertës. Shpimi i pusit duhet të kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK. Nëse shpimi i pusit nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri me specifikacionin e ofertes shpenzimet e bera biejnë në llogari të operatorit ekonomik. OE nuk do të pranohen edhe punet e kryera pa porosi të AK. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t'a ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë (OE) për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë.

Neni 3.5 **AFATI**

Shpurja e pusit për shkollën fillore "Hilmi Hoti" në fshatin Carrallukë do të kryhet brenda pesë (5) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4 PAGESA

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e kryerjes shpimit të pusit nga zyrtari përkatës dhe faturën nga kontraktuesi i dytë (OE) t'ia paguaj shumën sipas neni. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit të dytë do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit të caktuar nga ZKA i AK-së për menaxhim të kontratës).

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i puneve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të parashtuara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1. Garancioni do të mbetet valid për *12 muaj* mbas pranimi teknik të punimeve nga komisioni i cili do të caktohet nga ZKA i AK për pranim të shpuarjës se pusit (pranimi duhet të bëhet në përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës).

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej ndonjë ose të gjitha punet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë

të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së puneve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Fadil Thaçi
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	03/03/2020	Data:	03/03/2020
Vula:		Vula:	



Paramasa dhe paralogaria për :
Hapja e pusit eksploatues Tip C
Thellësia e pusit H= min 100.00m¹ - max =150.00m¹

Nr.	Pershkrimi i punimeve.	Njesia.	Sasia.	Çmimi€	Totali ME TVSH(€)
1	A Punët e dheut				
1,1	Shpurja e pusit në thellësi max. 150.00m ¹ dhe gjersinë 270.00mm me metoden e shpimit me ajr të komprimuar, apo me metodën me injektim të bentonit.	m ¹	150,00	22,00	3.300,00 €
2,1	Largimi i materialit të gërmuar pas hapjes së pusit deri në largsi 500.00m ¹	m ³	8,58	18,00	154,51 €
2	Gjithësejt Pjesa B:				€ 3.454,51
	B -Punimt me gypa PVC.				
2,2	Furnizimi, punimi, montimi, i gypave të fabrikuar si dhe gypa me vrima filtruese PVC-U PN10 Ø200.00mm t=10.00mm	m ¹	150,00	11,00	1.650,00 €
	Gjithësejt Pjesa B:				€ 1.650,00
3	C -Punët e zhavorit				
3,1	Furnizimi dhe vendosja e mbushjes filtruese për rreth gypit me gurë të thyer të pastër fraksion 3 - 8 mm ¹	m ³	2,84	€ 70,00	€ 198,45
3,2	Montimi i pompëse egzistuese komplet deri në fyndicion të plot si dhe pastrimi i pusit	copë	1,00	€ 3.100,00	€ 3.100,00
	Gjithësejt Pjesa C:				€ 3.298,45
	Rekapitullimi i punimeve (A+B+C)				8.402,96

